



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2020:073021

Datë: 07.11.2024

Numri i dokumentit: 06414764

C.nr.738/2020

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEGA NË VITI, gjyqtari Raif Fazliu, me bashkëpunëtorin profesional Agon Halabaku, në çështjen juridike civile kontestimore të paditësit B.Z., nga fshati P.i Vitisë, kundër të paditurit K.R. ngaG., Komuna e Vitisë, lidhur me padinë për vërtetimin e drejtës së pronësisë, në seancën gjyqësore në mungesë të palës paditëse me datë 05.11.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M
për tërheqjen e padisë

I. KONSIDEROHET e tërhequr padia e paditësit B.Z., nga fshati P.i Vitisë, kundër të paditurit K.R. ngaG., Komuna e Vitisë, për vërtetimin e drejtës së pronësisë,

Lënda me shenjë C.nr.738/2020, pas plotfuqishmris arkivohet në arkivin e kësaj gjykate.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi B.Z., nga fshati P.Komuna e Vitisë, më datë 22.06.2020, ka ushtruar padi me bazën juridike për vërtetimin e drejtës së pronësisë, duke paditur pasardhësin e pronarit juridik të ngastrës kadastrale nr.663-1, në zonën kadastrale në Viti, tani i ndjeri Tefik Ramadani (Hasan), djalin e tij K.R.) ngaG..

Gjykata ka caktuar seancën përgatitore për datën 05.11.2024, për në ora 14.00 min., mirëpo në seancë nuk ishte paraqitur fare pala paditëse, përkunder faktit që ftesën e kishte pranuar në mënyrë të rregullt nga gjykata, dhe të njëjtës nuk i ishte përgjigjur dhe mungesën nuk e kishte arsyetuar edhe pse të njëjten e kishte pranuar personalisht paditësi me datë 29.10.2024, apo 8 ditë, para mbajtjes se seancës përgatitore. Andaj, gjykata duke respektuar nenin 409.1 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është marrë duke u bazuar në nenin 450 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - DEGA NË VITI

C.nr.738/2020, Më 05.11.2024

Gjyqtari
Raif Fazliu

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur mund të ushtroj ankesë në afat prej 15 ditësh, pas ditës se pranimit të këtij aktvendimi, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.